

VENDIM
Nr.716, datë 23.6.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.693, DATË 10.11.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPALLJEN E KOMPLEKSIT LIGATINOR TË BUTRINTIT
“PARK KOMBËTAR””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në nënndarjen A₂, të zonimit të territorit të Parkut Kombëtar të Butrintit, të lejohet ngritja e strukturave ndihmëse të peshkimit, me sipërfaqe deri në 1 (një) ha, të cilat mundësojnë kryerjen e shërbimeve për veprimtarinë e akuakulturës.

2. Ngritja e këtyre strukturave të jetë në përshtatshmëri me funksionet e ruajtjes së natyrës dhe të biodiversitetit të nënzonave përkatëse.

3. Ngarkohet e Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha